



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTERIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO LOKALNE ADMINISTRACIJE
GOVERNMENT OF KOSOVO / MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", Kreu 5.2, Rregulloren e UNMIK 2000/45 "Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë", duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degen e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë", Neni 11 dhe Neni 30, Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Amendimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degen Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë" Shtojca XIV (iii) (b), (d) dhe (g), bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 "Mbi Shërbimin Civil të Kosovës" dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 "Mbi Shërbimin Civil të Kosovës", me qëllim promovimin e një shërbimi civil komunal profesional dhe përkrahjen e komunave për zbatimin efektiv të kompetencave të tyre, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr këtë:

KËSHILLË LIGJORE

Nr. 2007/02 datë 12.03.2007

"Për Procedurat e Punësimit dhe Përtëritjes së Kontratës së Drejtorëve të Drejtorive Komunale"

I. QËLLIMI I KËSHILLËS LIGJORE

Kjo shkresë ka për qëllim të ofrojë këshilla ligjore që Kuvendet Komunale udhëzohen të ndjekin për përtëritjen ose jo të kontratës së Drejtorëve të Drejtorive Komunale, për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të shërbimit civil komunal. Këshillat ligjore bazohen në dispozitat e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen lokale dhe shërbimin civil në Kosovë duke analizuar statusin, procedurën dhe rregullat ligjore për vlerësimin e punës dhe përtëritjen e kontratave të nepunësve civilë të cilat janë të zbatueshme edhe për rastin e Drejtorëve të Drejtorive Komunale.

II. PARASHTRIMI I ÇESHTJES

Pas monitorimit të komunave nga zyrtarët e MAPL-së është vërejtur se në shumë komuna, së shpejti do të skadoj kontrata me pjesë të konsiderueshme të Drejtorëve të Drejtorive

Komunale. Disa komuna përdorin procedura të ndryshme për vazhdimin e kontratës së drejtorëve të drejtorive komunale, të cilat procedura në të shumtën e rasteve janë në kundërshtim me aktet që mbulojnë këtë fushë. Për të shmangur situata të tilla, kjo çështje duhet të gjejë zgjidhje të qartë bazuar në ligjet e aplikueshme për vetëqeverisjen lokale dhe shërbimin civil në Kosovë.

III. **LIGJI I APLIKUESHËM PËR STATUSIN E DREJTORËVE TË DREJTORIVE KOMUNALE**

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, "Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë"

Pozita e Drejtorëve të Drejtorive Komunale rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 "Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Komunës." Neni 31 i kësaj rregulloreje përcakton mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të drejtorëve të drejtorive komunale. Rregullorja 2000/45 nuk përmban rregulla të hollësishme për kushtet e pranimit në punë dhe vijueshmërinë në detyrë të drejtorëve të drejtorive komunale, por Neni 11.3 (pika 1) e kësaj rregulloreje përcakton se Kuvendi i Komunës nuk mund të bartë përgjegjësinë e vet për vendimet lidhur me emërimin e Drejtorëve të Drejtorive Komunale, që nënkupton se instancë e fundit për emërimin e Drejtorëve të Drejtorive Komunale është Kuvendi Komunal. Neni 34.1 i Rregullores 2000/45 përcakton se shërbimin civil në komunë e përbejnë Kryeshefi Ekzekutiv, bordi i drejtorëve dhe personeli administrativ

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 "Mbi Shërbimin Civil të Kosovës"

Në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 (neni 1) Drejtorët e Drejtorive Komunale përfshihen në përkufizimin e nëpunësit civil pasi:

- a) Drejtorët e drejtorive komunale nuk emërohet nga ndonjë ministër ose deputet në cilësinë e këshilltarit, dhe
- b) Drejtorët e Drejtorive Komunale nuk emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për një periudhë kalimtare duke përfshirë pa kufizim individët e emëruar në pajtim me nenin 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19.

Ky formulim është i mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin se Drejtorët e Drejtorive Komunale janë nëpunës civil të një kategorie të veçantë.

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 "Mbi Shërbimin Civil të Kosovës"

Neni 2 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2003/2 shprehet se rregullat e përgjithshme të shërbimit civil aplikohen edhe për kategori të veçanta të shërbyesve civil që për shkak të kushteve specifike të detyrës së tyre nuk i nënshtrohen tërësisht procedurave të punësimit dhe karrierës si shërbyesit e tjerë civil.

Rregullorja 2000/45 ka epërsi mbi Rregulloren 2001/36 për ato çështje që ajo i rregullon shprehimisht dhe hollësisht siç është rasti i shkarkimit. Ndërsa, për kushtet e vlerësimit, skadimit ose përtërimit të kontratës Rregullorja 2000/45 nuk përmban rregulla të hollësishme prandaj, për këto çështje duhen respektuar parimet e përgjithshme të legjislacionit në fuqi për shërbimin civil.

IV. KËSHILLAT PËR PROCEDURAT E EMËRIMIT DHE PËRTËRITJËS

Duke qenë se Drejtorët e Drejtorive Komunale gëzojnë statusin e nëpunësit civil të kategorisë së veçantë, Kuvendi Komunal, që nga momenti kur e zgjedh Drejtorët e Drejtorive Komunale, bëhet organ punëdhënës. Si organ i punësimit, Kuvendi udhëzohet të respektojë parimet themelore të shërbimit civil në lidhje me procedurat e punësimit dhe përtërimit të kontratës si më poshtë:

1. Posti i Drejtorëve të Drejtorive Komunale duhet të shpallet publikisht dhe respektohen procedurat e ndershme, të hapura dhe konkurruese bazuar në kriteret objektive që lidhen me punën; Neni 2.1 pika (dh) I Rregullores 2001/36 dhe Neni 4 i Urdhërësës Administrative 2003/2;
2. Kuvendi i Komunes duhet të krijojë një panel/komision të kryesuar *ex officio* nga Kryetari i Komunes, i cili i paraqet Kuvendit të Komunes listën e kandidatëve të intervistuar nga paneli/komisioni dhe raportin vlerësues për secilin kandidat;
3. Kuvendi i Komunes në bazë të raportit vlerësues së paraqitur nga paneli/komisioni, emëron Drejtorët e Drejtorive komunale që janë vlerësuar me më shumë pikë nga paneli / komisioni.
4. Kontrata e punësimit duhet të jetë në formë të shkruar në pajtim me rregullat e punësimit në shërbimin civil (Neni 8.3), 8.4 dhe 8.6 i Urdhërësës Administrative 2003/2;
5. Kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë deri në tre vjet me mundësi ripërtëritje, Neni 8.5 i Urdhërësës Administrative 2003/2;
6. Shërbimi i Përsoneelit njofton Kuvendin 60 ditë para skadimit të kontratës së Drejtorëve të Drejtorive Komunale;
7. Kuvendi i Komunes, së paku një herë në vit, shqyrton-vlerëson punën e Drejtorëve të Drejtorive Komunale;
8. Në rastet kur Kuvendi ka vlerësime negative për punën e Drejtorëve të Drejtorive komunale formon një panel të vaçant nga anëtarët e Kuvendit për vërtetimin e gjendjes faktike;
9. Raporti i Vlerësimit të Punës së Drejtorëve të Drejtorive Komunale para se t'i dërgohet Kuvendit Komunal, duhet t'i dërgohet Drejtorëve të

Drejtorive Komunale; dhe nëse Paneli/Komisioni në vlerësimin e tij propozon mospërtëritje të kontratave, Drejtorëve të Drejtorive Komunale duhet t'u jepet mundësia të japin vërejtjet e tyre në lidhje me vlerësimin; (Neni 12) i Urdhëresës Administrative 2003/2;

10. Vetëm pasi Kuvendi të ketë vendosur (me vendim të arsyetuar) mospërtëritjen e kontratës, mund të shpallet konkursi për vendin vakant për Drejtorët e Drejtorive Komunale

11. Në rast se Kuvendi Komunal vendos mospërtëritjen e kontratës, Drejtorët e Drejtorive Komunale kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës së Kosovës. Neni 10 dhe 10.2 dhe 11 të i Rregullores 2001/36;

Parimi themelor i shërbimit civil është se nëpunësi civil, pavarësisht se punësohet me kontrata të afatizuara duhet të vijojë shërbimin dhe karrierën e tij persa kohë që performanca e tij në punë është në nivelin e kërkuar nga detyra e tij.

Lutfi Haziri

Zv. Kryeministër dhe Ministër i Administrimit të Pushteti Lokal